



A.nr.49/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.49/2026, të datës 15.01.2026, të parashtruar nga ankuesi SH.E, nga Prishtina, në çështjen juridike – administrative “*masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 30.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr. 49/2026, e datës 15.01.2026, e parashtruar nga ankuesi SH.E. **Shfuqizohet** Vendimi me Nr. T-54/25, i datës 18.12.2025 i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjti.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Autoritet të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj çështjen disiplinore të ankuesit, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetim të vendimit.

III. Obligohet Bordi i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmarrin veprime ligjore në kuptim të trajtimit të çështjes së pezullimit të Drejtorit të Përgjithshme si pasojë e rrethanave të krijuara më ngritje të aktakuzës PP.II.nr.7334/23, 18.03.2024.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi SH.E, (*tutje referuar ankuesi*), më datë 15.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. T-54/25, të datës 18.12.2025, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë në Autoritetin e Konkurrencës të Republikës së Kosovës (tutje AKRK), ndërsa, ky i fundit, ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 158/2026 të datës 15.01.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me Nr. T-54/25 të datës 18.12.2025 të Komisionit Disiplinor; Aktakuzën me numër PP.II.nr.7334/23; Aktvendimin me numër PP.II.nr.96/24 të datës 31.01.2024; Vendimin me Nr. 96/2024 i datës 31.05.2024 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Vendimin me Nr. 175/2025 i datës 11.07.2025 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Vendimin me Nr. 203/2025 i datës 21.08.2025 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Vendimin me nr. 33/24 të datës 22.03.2024 të Autoritetit të Konkurrencës; Vendimin me nr. 84/24 të datës 20.09.2024 të Autoritetit të Konkurrencës; Vendimin me nr. 86/24 të datës 26.09.2024 të Autoritetit të Konkurrencës; Opinionin për shqyrtimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik APK-DPKI-06-301.24 i datës 04.09.2024 i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; Vendimin A.nr.279/2025 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.2033/2024 të KPMSHCK-së; Konkluzion me Nr. 73/2023 të datës 03.08.2023 të Autoritetit të Konkurrencës; Vërtetimin me Nr. K 08/25 të datës 14.03.2025 të Autoritetit të Konkurrencës; vërtetimin me Nr. K 02/25 të datës 08.04.2025 të Autoritetit të Konkurrencës; vërtetimin me Nr. K 03/25 të datës 08.04.2025 të Autoritetit të Konkurrencës; vërtetimin me Nr. K 05/25 të datës 27.05.2025 të Autoritetit të Konkurrencës; vërtetimin me Nr. K 06/25 të datës 30.05.2025 të Autoritetit të Konkurrencës; Komunikimi me telefon; Shkresë me titull Pozicioni institucione lidhur me kërkesën për pezullimin e Drejtorit të Sekretariatit të AKRK-së datës 05.05.2025 nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës; Shkresë me titull përgjigje akuzave të pabazuara të S.B dhe N.B nga ankuesin për Komisionin Disiplinor të AKRK-së; Përgjigje për Komisionin Disiplinor në procedurën e iniciuar nga S.B më datë 06.10.2025 për seancën dëgjimore të datës 15.12.2025; Vendim Ref:01.10.2025/1720-2025 i datës 06.11.2025 nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës; Emailin e datës 10.09.2025 nga ankuesi për N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 07.01.2025 nga ankuesi për N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 04.12.2025 nga ankuesi për N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 10.09.2025 nga ankuesi për S.B; Emailin e datës 10.09.2025 nga S.B për A.R, A.F, F.Z; Emailin e datës 29.08.2025 nga S.B për A.R, A.F, F.Z, Sh.E; Emailin e datës 12.01.2026 nga ankuesi për N.B, K.S, N.O; Njoftimin e datës 27.12.2023; Vendimin me nr.116/23 të datës 13.12.2023 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr. 39/24 të datës 15.04.2024 për plotësim ndryshmin e vendimit për përbërjen e Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr. 68/24 të datës 01.08.2024 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr. 89/24 të datës 03.10.2024 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin me nr. T 30/25 të datës 13.08.2025 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor; Organogrami i AKRK-së; Emailin e datës 15.12.2025 nga ankuesi për A.T; Raporti për prezencë në punës për ankuesin datës 01.12.2025 deri 22.12.2025; Emailin e datës 10.12.2025 nga SIMBNJ për ankuesin; Raporti i prezencës në punë për ankuesin datës 10.11.2025, 11.11.2025; Emailin e datës 09.12.2025, 05.12.2025 nga ankuesin për I.Z; Emailin e datës 19.06.2025 nga ankuesi për N.B,K.S, N.O; Emailin e datës Emailin e datës 13.01.2026 nga ankuesi për Y.B, A.M, M.G, E.SH, A.H, N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 07.10.2025, 25.09.2025 nga ankues për Y.B dhe A.M; Emailin e datës 19.06.2025 nga ankuesi për N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 22.12.2025 nga ankuesin për I.Z; Emailin e datës 12.12.2025 nga N.O për N.B, K.S, etj; Emailin e datës 12.12.2025 nga N.B për K.S, N.O; Emailin e datës 11.12.2025 nga N.O për N.B, K.S, S.B etj; Emailin e datës 11.12.2025 dhe 08.12.2025 nga K.S për N.B, S.B etj; Emailin e datës 08.01.2026 nga K.S për N.B; Emailin e datës 28.01.2026 nga G.L për S.B, N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 28.01.2026 nga S.B për G.L, N.B; Emailin e datës 27.01.2026 nga G.L për N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 27.01.2026 nga S.B

për E.T, R.A, A.GJ. F.Z, B.B, Sh.E, G.L; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 30.01.2026; Akt Emërimit e datës 18.06.2025 të ankuesit; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 25.09.2025 dhe 05.12.2025 nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës ndaj ankuesit; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nga S.B më datë 25.09.2025, 06.10.2025 ora 9:52, 06.10.2025 ora 10:12, 06.01.2025 ora 10:21 ndaj ankuesit; Emailin e datës 04.12.2025 nga ankuesin për N.B, K.S, N.O; Ekstrakt i procesverbalin të seancës së Komisionit Disiplinor datës 01.10.2025, datës 15.12.2025; Plan Individual i punës për vitin 2025 për ankuesin datës 29.05.2025; Transkripti postimit të ankuesit në Facebook.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton se:

- Ankuesi sipas Aktit të Emërimit me Nr. AE-23/2025, të datës 18.06.2025, është i punësuar në pozitën Inspektor Hetues i Konkurrencës, në Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregut/Autoriteti i Konkurrencës.

- Kryetarja e Bordit të AKRK-së përmes e-mailit të datës 25.09.2025, i është drejtuar Komisionit Disiplinor, më kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të dyshimit për shkelje të rëndë të etikes profesionale dhe dëmtimit të reputacionit të institucionit, përmes postimit në rrjetin social Facebook, më datë 24.09.2025, përmes të cilit ankuesi ka bërë akuza të rënda, të pabazuara dhe të pa vërteta ndaj institucion dhe udhëheqësve të tij. Tuje, sipas kërkesës ky postim përmban etiketime të udhëheqësve si të kundërligjshme, abuzive, shkelës të ligjit dhe keqpërdorues të funksionit publik, deklarime tendencioze e të rreme mbi procedurat hetimore dhe proceduarve të brendshme të institucionit për rastet duke i paraqitur në publik si të jashtëligjshëm, përhapje e informacioneve të brendshme pa autorizim dhe në kundërshtim me detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit institucional, keqinterpretimin e qëllimshëm të vendimeve të institucioneve tjera si AIP, Policia e Kosovës dhe KPMSHCK, për të ndërtuar një narrativë të rreme për gjoja shkelje ligjore nga ana e institucionit dhe akuza publike për vëzhgim ilegal dhe sulm fizik.

-Drejtori i Përgjithshëm i AKRK-së më datë 25.09.2025, përmes emailit ka parashtruar kërkesë të Komisioni Disiplinor për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesi me arsyetimin se: *I njëjti ka nisur një fushatë sulmuese dhe goditjes publike përmes profilit të tij në Facebook, duke cenuar pa të drejtë figurën e kryetares se AKRK-së ai keqpërdor informacionet e brendshme të institucionit; Përveç kësaj ai keqpërdore kompetencat e tij, bënë interpretime ligjore pa kompetencë, shpif për procese të institucionit; Ka ngritur akuza të paarsyeshme dhe të pabazuara lidhur me veprimet e kryetares dhe drejtorit të përgjithshëm dhe veprimet e tij duke përfshirë edhe sulme të drejtpërdrejta fizike dhe shpifje të vazhdueshme. Më datë 06.10.2025, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës përmes emailit dërguar anëtarëve të Komisionit Disiplinor ka parashtruar kërkesë për shqyrtim disiplinor për mos përmbushje të detyrave të punës, neglizhencës të vazhdueshme në përmbushjen e detyrave të punës dhe mosrespektim të afateve zyrtare, ndërsa po ashtu të njëjtën ditë më datë 06.10.2025, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës përmes emailit dërguar anëtarëve të Komisionit Disiplinor ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore për mos kryerjen e detyrave të punës për rastin KEDS dhe KESCO.*

- Serish më datë 05.12.2025, Kryetarja e Bordit të AKRK-së ka përcjell pranë Komisionit Disiplinor, kërkesë për masë disiplinore ndaj ankuesit për shkak se i njëjti ka dërguar disa emaila që përmbajnë insinuata, shpifje dhe pretendime të pabazuara ndaj saj, jashtë çdo lidhjeje dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Sjellje këto që ndikojnë drejtpërdrejt në punën dhe arritjen e objektivave të AKRK-së.

- Më datë 06.10.2025, Drejtori i Përgjithshëm i AKRK-së ka përcjell tri emaila tek Komisioni Disiplinor dhe atë emali i orës 9:52, kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj inspektorit SH.Epër moskryerje të detyrave të punës dhe mosrespektim të afateve të përcaktuara, pasi që ankuesi nuk ka përgatitur dhe nuk ka përcjell më kohë përgjigje ndaj kërkesës për Informacion (RFI) të parashtruara nga Autoriteti i Konkurrencës së Shqipërisë, e sipas iniciuesit ky veprim ka cenuar përmbushjen më kohë të obligimeve të AKRK-së ndaj institucioneve homologe si dhe ka rrezikuar reputacionin e institucionit në raport më marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit, emaili i orës kurse në ora 10:12 kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj inspektorit SH.E për moskryerje të detyrave të punës në rastin e KEDS dhe KESCO, dhe emaili i orës 10:21, kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj inspektorit SH.E. për mos raportim dhe moskryerje të detyrave të punës.

- Komisioni Disiplinor i AKRK-së më Vendimin Nr. T-54/25, të datës 18.12.2025, ka aprovuar dy kërkesat për inicim të procedurës të Republikës së Kosovës disiplinore nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës (kërkesën e datës 29.05.2025 or 10:27 dhe të datës 05.12.2025 ora 14:56) dhe tri kërkesa të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës (e datës 25.09.2025 ora 15.50, e datës 06.10.2025 ora 9:52, dhe datës 06.10.2025 ora 10.2021, ndërsa, ka refuzuar kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për mos përmbushje detyrave të punës për rastin KEDS dhe KESCO emaili i datës 06.10.2025, ora 10:12), ndërsa sipas pikës II të dipsozitivit ndaj ankuesit është shqiptuar masa disiplinor “ pezullimi nga pozita me ndalim prej 40% (dyzet për qind) të pagës bazë për periudhën 10 (dhjetë) mujore.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton Vendimin Nr.T-54/25 të datës 18.12.2025, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës, duke pretenduar se Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës me rastin e iniciimit të procedurës disiplinore ka përdorur bazën ligjore e cila nuk është në fuqi. Tutje pretendon se postimin në Facebook e ka bërë si sinjalizues sepse të gjitha janë të vërteta dhe i kam ngritur edhe brenda institucionit dhe për këtë çështje jam i mbrojtur sipas ligjit përkatës për sinjalizuesit. Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, pas asnjë bazë ligjore më ka iniciuar procedurë disiplinore, po ashtu edhe kërkesat për iniciimin e procedurës disiplinore nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës janë pa bazë juridike sepse edhe i njëjti përmes postimit të tij më datë 20.09.2025 në Facebook më ka quajtur “tugjar”, po ashtu i njëjti është dashur të tërhiqet nga procedura për shkak që kjo është thënë nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe sipas Vendimit A.nr.279/2025 të KPMSHCK-së dhe përgjegjësia për përgjigje ndaj autoritetit të Shqipërisë nuk ka qenë e imja. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar, të shpallet komisioni disiplinor si i paligjshëm për shkak që është themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm, të obligojë titullarin e institucionit Kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës të nxjerr vendim për pezullimin nga marrëdhënia e punës të Drejtorit të Përgjithshëm.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislationin në fuqi”.*

- Nenit 57 paragrafi 2: *“Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; **2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit;** 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

-Nenit 59 paragrafi 3, ku përcaktohet: 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

Kolegji i Këshillit bazuar në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale të deponuara nga palët në procedurë ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i AKRK-së me rastin e shqyrtimit të çështjes disiplinore të ankuesit kishte dështuar në vërtetimin e fakteve relevante, gjegjësisht, Komisioni Disiplinor fillimisht duhet të konstatonte faktin bazë nëse Kryetarja e Bordit të AKRK-së ka tagër ligjor të parashtror kërkesa për inicim

të procedurës disiplinore ndaj nëpunësve civile të administratës së AKRK-së, rrjedhimisht, e njëjta a konsiderohet person kompetent siç përcaktohet më nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu, Komisioni Disiplinor më rastin e vendosjes lidhur me çështjen kontestuese nuk kishte marrë në konsideratë faktin nëse në procedurën konkrete ekzistojnë rrethanat e përjashtimit sipas nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Ligjit Nr.05/L 031 për Procedurën e Përgjithshme administrative ku përcaktohet se: *“29.1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërën nga këto situata: 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij.”*, sepse, sipas shkresave të lëndës del se ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuza PP.II.nr.7334/23, datë 18.03.2024, për veprën penal nga neni 185 paragrafi 1, pika 1.4 të KPRK-së, rrjedhimisht, sipas arsytimit të këtij akti penal thuhet” *...së më datë 29.11.2023, në Zyrën e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, i pandehur më dashje që ti shkaktoj lëndim trupor personit tjetër, tani të dëmtuarit SH.E, i njëjti e kishte sulmuar, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake.. nga mbrapa fillon ta sulmoj më shqelmi dhe duar në pjesë të ndryshme të rupit.. më ç’ast i dëmtuari si pasojë e goditjeve pëson ndrydhje në kokë dhe dërrmishje”*.

Në fakt, KPMSHCK më Vendimin A.nr.1823/2025 të datës 26.03.2025, dhe A.nr.279/2025, të datës 07.04.2025, ka qëndrim të konsoliduar duke konstatuar së përkundër faktit së Bordi i AKRK-se nuk ka ndërmarr veprime në kuptim të pezullimit të Drejtorit të Përgjithshëm, rrethanat e ngritjes së aktakuzës PP.II.nr.7334/23, 18.03.2024, ndaj tij, bëjnë që ky i fundit të mos të ketë autorizime ligjor për ndërmarrje të veprimeve dhe përbejnë shkak ligjor të përjashtimit në një procedurë administrative ku si palë është ankuesi.

Rrjedhimisht, mbështetur në mandatin kushtetues të KPMSHCK që të garantoj zbatimin e parimeve dhe rregullave të Shërbimit civil (neni 101 i Kushtetues), e në kuptim të ruajtjes së interesit publik, Kolegji vendosi si në pikën III të dispozitivit, duke detyruar Bordin e AKRP-së që të ndërmerr veprime të nevojshme në kuptim të shqyrtimit të rrethanave ligjore për pezullim të Drejtorit të Përgjithshëm, veprime këto të domosdoshme në mbrojtje të integritetit të institucionit dhe besimit të publikut në punën e AKRK-së.

Andaj, nisur nga gjetjet dhe vlerësimet si më lart, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së për shkak të të metave të konstatuar, vendosja meritorë lidhur me këtë çështje disiplinore nuk është e mundur, kështu që, më qëllim të kthimit të ligjshmërisë e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar, anuloj Vendimin e kontestuar, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës, me detyrimin që ky i fundit të konstatoj kompetencës e parashtuesve të kërkesave për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, të garantoj parimet e mbrojtjes dhe ndihmës juridike, dhe të nxjerr vendim vetëm pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe më zbatim të drejtë të ligjit material.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.49/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit SH.E;*
- *Autoritetit të Konkurrencës; Bordit, Komisionit Disiplinor dhe Njesisë së Personelit*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*